



DEF Département de l'enseignement
et de la formation professionnelle
DGEO Direction générale de l'enseignement
obligatoire et de la pédagogie spécialisée

Zgjedhjet e aftësive të orientuara drejt profesioneve të drejtimit të përgjithshëm Informim për prindërit

**Shkalla e dytë
(arsimi i mesëm i ulët)**

Vitet 9S deri në 11S

Në plotësim të fletëpalosjes që paraqet vitin e 9-të e të 10-të të shkollës së dytë I (cikli 3), ky dokument përshkruan zgjedhjet e aftësive të orientuara drejt profesioneve (OCOM). Këto zgjedhje janë një prej përbërëseve të forta të drejtimit të përgjithshëm. Ato mundësojnë shtimin e aftësive të nxënësve për të hyrë në një formim profesional, në shkollë të kulturës së përgjithshme e të tregtisë të gjimnazeve ose të maturës profesionale.

OCOM-të janë futur në tabelën e orarit të vitit të 9-të, të 10-të e të 11-të në zbatim të nenit 94 të ligjit mbi arsimin e detyrueshëm (LEO) dhe të nenit 70 të rregullores së zbatimit të tij (RLEO), si dhe të vendimit të departamentit n° 57 « Zgjedhja e aftësive të orientuara drejt profesioneve ».

www.vd.ch/scolarité

Burimet : Loi sur l'enseignement obligatoire (LEO)
Règlement d'application de la LEO (RLEO)
Cadre général de l'évaluation (CGE)

Bazë është vetëm kuadri ligjor e rregullator dhe Kuadri i përgjithshëm i vlerësimit (CGE), i cili i trajton në mënyrë shterruese rastet e ndryshme.

Të përgjithshme

Për një punë me projekt vetjak apo kolektiv, zgjedhjet e aftësive të orientuara drejt profesioneve (OCOM) synojnë të zhvillojnë mëvetësinë e nxënësve, t'u mësojnë si të bashkëpunojnë dhe t'u mundësojnë atyre që të ushtrohen në bërjen e zgjedhjeve të ndryshme. Në kuadrin e OCOM-ve, nxëniet e bëra në zbatime konkrete mobilizojnë dhe zhvillojnë njohuritë shkollore të nxënësve, përforcojnë kuptimin e njohurive të mara në klasë dhe mbështesin përvetësimin prej nxënësve të aftësive të nevojshme për të hyrë në formimin profesional fillestar.

Kuadri i zgjedhjeve të aftësive të orientuara drejt profesioneve

4 periudhat e OCOM-ve ndahen në dy grupe: grupi Formim i përgjithshëm dhe grupi i zgjedhjeve artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike (AACT).

Grupi Formim i përgjithshëm, që i jepet tërë klasës në 2 periudha javore, përfshin tematikat *Mediat, figurat, teknologjitë e informimit dhe komunikimit* (MITIC) et *Zgjedhje me dëshirë dhe projekte vetjake* (qasje në botën profesionale - AMP). Përmes projekteve, punohen edhe MITIC-të, frëngjishtja, matematika dhe OCOM AATT-të. Një vend mbizotërues i jepet AMP-së, në vitin e 10-të e të 11-të. Një pjesë e kësaj kohe shkollore mund t'i kushtohet gjithashtu administrimit të klasës.

Zgjedhjet artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike synojnë të plotësojnë formimin e nxënësit në lëndë e tematika të ndryshme të Planit romand të studimeve (PER) ose të shtojcave plotësuese vaudeze të tij. Institucionet ofrojnë OCOM AATT nga lista e mëposhtme dhe në lidhje me të paktën tri paragrafe të ndryshme të PER-së.

Plani romand i studimeve (PER)

www.plandetudes.ch

PER-ja përcakton përmbajtjen e të nxënit të shkollimit të detyrueshëm për Zvicrën romande. Ai përshkruan atë që nxënësit duhet të mësojnë gjatë njëmbëdhjetë viteve të shkollimit.

Zgjedhjet artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike (OCOM AATT)

Veprimtari krijuese dhe punë dore
Artet vizuale

Ekonomi, drejtësi dhe qytetari

Edukimi i të ushqyerit

MITIC - Teknologjia numerike

Shkencat e natyrës

Me lejen e departamentit, një institucion shkollor në mënyrë përjashtimore mund të propozojë një zgjedhje në lidhje me një lëndë tjetër që përgatit për formimin profesional fillestar.

Vendimi për zgjedhjen përfundimtare të degëve merret prej këshillit drejtues, i cili mban parasysh kushtet e mësimdhënies dhe mundësitë materiale në dispozicion.

Marrja sipas dëshirës e zgjedhjes artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike

Në përfundim të vitit të 8-të, nxënësi zgjedh një OCOM që i përket grupit të zgjedhjeve artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike (AACT), të cilën në parim do të ndjekë gjatë tërë shkallës së dytë.

Në përfundim të vitit të 9-të, nxënësi ka mundësi ta rishikojë zgjedhjen e tij sipas projektit të tij të formimit.

Në përfundim të vitit të 10-të, ndryshimi i OCOM AACT-së është i rezervuar.

Çdo ndërrim dege duhet të kërkohet prej prindërve dhe të arsyetohet prej nxënësit.

Mënyrat e vlerësimit

Ndër OCOM-të, vetëm zgjedhjet artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike (AACT) janë objekt vlerësimi. Mesatarja e tyre mbahet parasysht nga njëra anë në grupin kryesor të përbërë nga të gjitha lëndët dhe nga ana tjetër në një grup të kufizuar lëndësh.

Grupi i kufizuar frëngjisht + matematikë + gjermanisht + zgjedhje artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike

Provimi i certifikatës

Në fund të vitit të 11-të, OCOM AACT-ja bën pjesë në lëndët që i nënshtrohen provimit të certifikatës. Ajo është objekt i një provimi me gojë dhe/ose me shkrim, apo në një formë tjetër në përshtatje me përmbajtjet e saj. Ashtu si për lëndët e tjera që janë objekt provimi, mesatarja vjetore përfundimtare e OCOM AACT-së mban parasysht mesataren vjetore në masën 80 % dhe notën e marë në provim në masën 20 %.

Punët domethënëse (travaux significatifs, TS) (përdorimi i njohurive): Në mënyrë të rregullt e përgjatë tërë vitit, vlerësimi i punës shkollore të nxënësit bëhet me ndihmën e punëve domethënëse. Ato përbëjnë elementet thelbësore të vlerësimit. Çdo punë domethënëse synon të paktënjë objektiv mësimor të përcaktuar nga Plani romand i studimeve (PER) me një apo disa prej përbërësve të tij që kanë qenë objekt i një mësimdhënieje.

Punët e përvetësuara (travaux assimilés, TA) (përvetësimi i njohurive): Një sërë punësh që verifikojnë vetëm përvetësimin e njohurive ose të teknikave të veçanta. Të gjitha këto punë janë objekt i një note për çdo lëndë. Për çdo lëndë, numri i punëve të përvetësuara nuk mund të kalojë një të katërtën e të gjitha punëve të përcaktuara.

Mesatarja vjetore, shembull llogaritjeje

Mesatarja e notave të mara në klasë	4.2
Nota e marë në provimin e certifikatës	4.5
Llogaritja: $(4.5 \times 0.8) + (4 \times 0.2) =$	4.3
Mesatarja vjetore përfundimtare (e rumbullakosur me gjysmëpikë)	4.5

Paraqitje e ciklit 3

Një fletëpalosje shpjeguese lidhur me ciklin 3, dhe në veçanti me vitin e 9-të e të 10-të, gjendet në sitin tonë të Internetit:

www.vd.ch/scolarite > Déroulement de l'école obligatoire dans le canton de Vaud.

Certifikimi në fund të vitit të 11-të

Një fletëpalosje lidhur me kushtet e certifikimit të nxënësve të vitit të 11-të dhe kushtet e hyrjes në klasat e rakordimit, në klasat e vitit të 12-të certifikues, si dhe në formimet pas shkollimit të detyrueshëm gjendet në sitin tonë të Internetit:

www.vd.ch/scolarite > Déroulement de l'école obligatoire dans le canton de Vaud.

Struktura e shkollës së detyrueshme vaudeze

		Rac1 et Rac2 viti i 12-të certifikues		shkalla e dytë (arsimi i mesëm i ulët)
14 - 15 vjeç	11S	cikli i tretë drejtimi i përgjithshëm	cikli i tretë drejtimi paragjimnazial	
13 - 14 vjeç	10S			
12 - 13 vjeç	9S			
11 - 12 vjeç	8P	cikli i dytë fillor		shkalla e parë (arsimi fillor)
10 - 11 vjeç	7P			
9 - 10 vjeç	6P			
8 - 9 vjeç	5P			
7 - 8 vjeç	4P	cikli i parë fillor		
6 - 7 vjeç	3P			
5 - 6 vjeç	2P			
4 - 5 vjeç	1P			



www.vd.ch/scolarite

www.vd.ch/page/2020664

